



PLANI I INTEGRITETIT

Komuna e Mamushës

2016 -2020



PLANI I INTEGRITETIT

Komuna e Mamushës

2016 -2020

Mars 2016

PËRMBAJTJA

Deklarata e integritetit	5
Plani i integritetit	8
Objektivat strategjike, linjat e aktiviteve dhe masat	11
Objektivi Strategjik 1:	11
Objektivi Strategjik 2:	22
Objektivi Strategjik 3:	33
Plani i veprimit	37

MIRËNJOHJE

Grupi Punues i Komunës së Mamushës:

Arif Bütüç	Kryetar i Komunës
Ilyas Bayraktar	Nënkryetar i Komunës
Ganimete Sadiku	Nënkryetar i Komunës
Fuat Tac	Kryesues i Kuvendit Komunal
Cafer Morina	Drejt看 Arsim dhe Shkencë
Skender Sala	Drejt看 Buxhet dhe Financa
Rujdi Kruezi	Drejt看 Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Resat Mazrek	Drejt看 i Administratës së Përgjithshme
Yalcin Mazrek	Drejt看 Kadastër dhe Gjeodezi
Agim Morina	Drejt看 i Shërbimeve Publike

Dokumenti është hartuar me mbështetje nga Ekipi i Projektit të UNDP-së Mbështetje përpjekjeve kundër korrupsionit në Kosovë (SAEK).

Plani i Integritetit për Komunën e Mamushës (2016-2020) është përgatitur dhe publikuar me ndihmën bujare të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Kosovë. Ndërsa është mbështetur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë.

Mohim përgjegjësie: Përmbajtja e këtij dokumenti nuk paraqet medoemos pikëpamjet e UNDP-së apo SDC-së. Hartimi i dokumentit është realizuar bashkarisht nga Komuna e Mamushës dhe ekipit të Projektit Anti-Korrupsion (SAEK) të UNDP-së.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Kosovo

DEKLARATA E INTEGRITETIT

Kjo deklaratë autorizon, informon, udhëheq, mirëmban dhe është e rëndësishme për proceset e menaxhimit të rrezikut të integritetit në komunën e Mamushës. Ky Plan është ndërtuar mbi miratimin e Strategjisë kosovare Kundër Korrupsionit dhe Planit të saj të Veprimit, e që kërkon hartimin e planifikimit të integritetit si një nga komponentët kyç. Njëkohësisht ndërlidhet me agjendën dinamike të Kosovës për modernizimin e administratës publike nëpërmjet mbështetjes së aktiviteteve për rritjen e efikasitetit, efektivitetit, llogaridhënies dhe transparencës në funksionimin e institucioneve publike. Mbi të gjitha, kjo deklaratë vjen si rezultat i vendosmërisë tonë të fuqishme se menaxhimi efektiv i integritetit është një prioritet i lartë për ne duke qenë se na ndihmon në rishikimin e proceseve tona komunale, në riorganizimin dhe riformulimin e procedurave tona dhe në forcimin e besimit në të gjitha nivelet. Komuna jonë e vogël rurale e shtrihet në pjesën jugore të Kosovës, është unike dhe e avancuar në shumë aspekte. Që nga viti 1985 kemi funksionuar në mënyrë efektive si komunitet rural edhe pse deri vonë nuk e kishim statusin si qendër administrative dhe si komunë. Kemi në përkujdesje një vendbanim me 9 lagje dhe rreth 6,000 banorë. Jemi krenar për mbajtjen e një rekordi të gjatë të tolerancës etnike dhe respektim të diversitetit shumetnik marr parasysh që popullata jonë përbëhet nga turqit, shqiptarët dhe komunitet romë, ashkali dhe egjiptian.

Si pushtet lokal, jemi të vendosur në mbështetjen efektive të të gjitha bizneseve që operojnë në komunën tonë. Historikisht, popullata e Mamushës ka shfaqur proaktivitet të konsiderueshëm afarist dhe frymë sipërmarrëse. Si administratë komunale, kjo na ka inkurajuar që të ngërthejmë këtë qëndrim edhe në punën tonë qeverisëse. Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve tona është bërë prioritet. Synojmë që të gjitha kërkesat e komunitetit të biznesit të shqyrtohen dhe përshtaten me shpejtësi, në mënyrë që të përmbushen të gjitha nevojat e tyre. Me qëllim të tërheqjes së investimeve, kemi vazhduar me heqjen e taksave për bizneset e reja, për vitet e para të operimit të tyre, nga 1 deri në 3 vjet. Prandaj, tani jemi krenar kur i referohemi afër 800 bizneseve aktive në territorin e komunës. Udhëhiqemi nga ambicia që ta rrisim në maksimum potencialin e madh të Mamushës, e cila ka një nga tokat më pjellore në rajon dhe ofron mundësi të shkëlqyera për kultivimin e pemëve dhe perimeve. Stimulimi i përpunimit të ushqimit të shëndetshëm dhe bujqësisë organike ka potencial për të dalluar komunën tonë nga komunat e tjera në rajon. Në vijim të kësaj, ne kemi zhvilluar sektorin e tregtisë dhe promovimin e trashëgimisë sonë të pasur kulturore, që i ka dhënë formë një sjelljeje qetësuese dhe mikpritëse ndaj të gjithëve.

Integrojmë misionin tonë me përgjegjësitë tona. E dimë fort mirë se me rritjen e mundësive të zhvillimit dhe me zgjerimin e kompetencave tona, rritet edhe potenciali për sjellje abuzive. Ne veprojmë në një mjedis kompleks administrativ, me shumë rregullore në nivele të ndryshme, që nganjëherë mund të mos jenë koherente dhe paraqesin sfida për zbatimin e tyre efektiv. Ku procedurat e stërngarkuara administrative paraqesin rrezikshesë për shërbime efektive dhe efikase. Zyrtarët komunalë gëzojnë pushtet dhe monopol të konsiderueshëm mbi shërbimet publike, si në zhvillimin ekonomik lokal, në shëndetësi, arsim, banim, tokë, ujë, etj. Jemi krenarë për mbajtjen e ndërveprimeve të ngushta në aspektin e ofrimit të shërbimeve dhe vlerësimit të secilit klientit, edhe pse kjo mundet gjithashtu të nxis mundësinë për korrupsion. Në një komunitet të vogël, si ky i yni, kontaktet lokale dhe marrëdhëniet familjare janë me rendësi, pasi që ato janë pjesë e mjedisit përkatës. Edhe pse kjo mund të lehtësojë dialogun dhe mirëkuptimin, kjo e krijon rrezikun për nepotizëm dhe favorizim, që mund të ndikojë në integritetin profesional dhe inkurajon vendime të njëanshme. Besojmë në kërkesat e bëra nga konsumatorët për rritjen e cilësisë së shërbimeve tona, por po ashtu kemi nevojë të ndërtojmë një qëndrim pro-aktiv të klientëve tanë. Mungesa e mediave aktive lokale dhe e një shoqërie të fuqishme civile, dobëson mekanizmat e mbikëqyrjes nga qytetarët, që e konsiderojmë si thelbësore për të ruajtur një klimë të shëndoshë të integritetit. Mungesa e burimeve, për sa i përket infrastrukturës dhe mjedisit të punës, si dhe e ekspertizës profesionale, paraqesin po ashtu sfida serioze.

Duke pasur parasysh si më sipër, e shohim mbrojtjen e integritetit si zgjedhjen tonë të ndërgjegjshme. Sfida jonë më e madhe shndërrimi i gjithë sistemit dhe proceseve në të cilat jetojnë dhe veprojnë në një sistem më të rezistueshëm ndaj presioneve abuzive në mënyrë që biznesi ynë, ekonomia jonë dhe bashkësia jonë lokale të mund të mbijetojnë dhe përparojnë. Rezistueshmëria nënkupton zvogëlimin e cenueshmërisë, në mënyrë që sistemet tona komunale të jenë më të afta t'i bëjnë ballë presioneve të shtuara, si nga jashtë, ashtu edhe nga brenda. Rezistueshmëria gjithashtu nënkupton të qenit në gjendje që të krijojnë sa më shumë mundësi të cilat mund të vijnë si mbështetje e marrë nga shteti ose nga bashkësia ndërkombëtare, bizneset vendore, shoqëria civile dhe mediat, si dhe nga qytetarët tanë. Me qëllim të arritjes së kësaj më lart jemi të vendosur që të:

- Ruajmë një politikë të drejtpërdrejt për rrezikun e integritetit e cila është adekuate për vizionin, misionin dhe mandatin tonë, dhe është në përputhje me reformën e përgjithshme kundër-korrupsionit dhe modernizimit publik;

- Përmirësojmë vazhdimisht cilësinë dhe efektivitetin e menaxhimit të rrezikut të integritetit, të fuqizojmë kapacitet vendore në këtë drejtim, të zbatojnë masat e planit të integritetit, të parashikojmë monitorimin dhe vlerësimin, dhe gradualisht të zhvendosemi drejt një kulture të re të vendimmarrjes së informuar bazuar në rrezik;
- Rishikojmë praktikrat dhe procedurat tona për të rritur nivelin e mbrojtjes kundër shkeljeve të integritetit;
- Zbatojmë në mënyrë të vazhdueshme politika të “tolerancës zero” ndaj korrupsionit; të bashkëpunojmë në mënyrë efektive me institucionet përgjegjëse në fushën kundër korrupsionit;
- Vlerësojmë dhe promovojmë integritetin në çdo kohë duke u mbështetur në standardet profesionale dhe vlerat morale; të sigurojmë zbatimin efektiv të Kodit të Etikës për Shërbyesit Civil; të respektojmë rregulloret e konfliktit të interesit, të përmbahemi nga përfshirja në ndonjë punë apo transaksion apo që ka ndonjë interes financiar apo ndonjë interes tjetër personal, që është ose që mund të jetë në kundërshtim me kryerjen e detyrave zyrtare, dhe për të shmangur nepotizmit dhe favorizimet;
- Përmbahemi nga ndonjë sjellje e cila mund të sjellë humbje financiare, ose të na shmang nga imazhi i integritetit apo profesionalizmit së Komunës së Mamushës.

Unë, me këtë rast, mund të deklarojë mbështetjen time të plotë dhe të pakushtëzuar dhe përkushtimin tim të fuqishëm në të gjitha përpjekjet për fuqizimin e mbrojtjes së integritetit brenda Komunës së Mamushës.

Arif Bütüç
Kryetari i Komunës së Mamushës
2016

PLANI I INTEGRITETIT

Plani i Integritetit rritet dhe përkushtimin e Komunes së Mamushës për të rritur më tej kontrollin ekzistues operativ në spektrin e plotë të aktiviteteve të kryera, me fokus në ofrimin e shërbimeve transparente dhe efikase me klientin në qendër. Plani parashikon masa të bazuara në rrezik, për arritjen e objektivave të tija të integritetit dhe forcimin e sundimit të ligjit dhe të vlerave, si dhe standardeve profesionale. Ky Plan do të luajë një rol të rëndësishëm për Komunën në:

- menaxhimin e rrezikut të integritetit për tërë organizatën me fokus strategjik në fushat me rrezik të lartë; balancimin e menaxhimit proaktiv të rrezikut të integritetit me atë reaktiv; zvogëlimin/eliminimin e mundësive për korrupsion dhe përmirësimin e rezistueshmërisë së përgjithshme ndaj korrupsionit;
- forcimin e pajtueshmërisë me kërkesat përkatëse ligjore dhe procedurale dhe me standardet më të larta ndërkombëtare të menaxhimit;
- zhvillimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve të të gjithë stafit për një integritet efektiv në parandalimin dhe zbulimin e dobësive, për ngritjen e vetëdijes në të gjitha nivelet dhe funksionet, për të inkurajuar angazhimin kolektiv dhe bashkë-pronësisë në menaxhimin e integritetit;
- përmirësimin e kuadrit të mirëbesimit me akterët e jashtëm dhe të brendshëm, dhe për t'iu përgjigjur kërkesave dhe pritjeve të tyre për sa i përket performancës së integritetit të Komunes.

Plani mbështetet në *rezultatet e një procesi gjithëpërfshirës të planifikimit të integritetit dhe vlerësimit të rrezikut*, të ndërmarra në kuadër të Komunes së Mamushës dhe që janë kryer në periudhën tetor 2015 - shkurt 2016. Ky proces ka përfshirë *identifikimin* e dobësive organizative të cilat mund të qojnë në shkelje të integritetit, si dhe *vlerësimin* e tyre duke marrë në konsideratë (1) dëmin në aspektin material dhe jo-material që shkeljet potenciale përkatëse shkaktojnë dhe (2) mundësinë që ngjarjet e tilla mund të ndodhin, e parë përmes rezistencës organizative aktuale të mbështetur në rregulloret, procedurat, kodet, praktikat përkatëse dhe përfshirjen e personelit. Për të përmbushur pikat e sipërpërmendura, Komuna ka ndërmarrë veprimet në vijim:

- Janë caktuar përgjegjësitë për planifikimin e integritetit nëpërmjet krijimit të Grupit Punues të udhëhequr nga Kryetari i Komunes së Mamushës;

- Është hulumtuar korniza strategjike, rregullative dhe operative gjegjëse e Komunës;
- Janë analizuar të dhëna nga performanca, monitorimi dhe implementimi i integritetit;
- Ka zhvilluar një mjet referues për vetëvlerësimin e organizatës që të ofrojë informacion dhe të dhëna të dobishme për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të integritetit në Komunë; bazuar në rezultate, fushat e identifikuara të rrezikut dhe përmirësimin e linjave dhe masave operative (është zhvilluar sistemi për vetëvlerësimin e integritetit të organizatës);
- Ka përdorur punëtori me fokus grupe dhe tabela të përpunuara të rrezikut për trajtimin e rreziqeve specifike në njësitë kyçe administrative dhe fushat me rrezik të lartë për të identifikuar dhe vlerësuar rreziqet e integritetit dhe për të listuar masat parandaluese (punësoria dhe intervistat e mbajtura; Regjistri i Rrezikut të Integritetit i zhvilluar);
- Janë përdorur dokumentet/udhëzimet që lidhet me zhvillimin e integritetit të UNDP-së, Konspektet e Praktikave më të Mira të Integritetit, doracak të Transparency International, standardet e menaxhimit të rrezikut ISO 31000 dhe FERMA, Specifikacioni BS 10500 për sistemin e menaxhimit kundër mitosjes; standardi Australian/Zelandës së Re kundër korrupsionit – AS 8001-2008; Udhëzimi ISO 26000 për përgjegjësinë shoqërore; Parimet e Punës së Transparency International në luftimin e mitmarrjes; Kërkesat e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001 dhe Menaxhimi i Sigurimit të Informacionit ISO 27001; si referencë për të mbështetur masat e propozuara.

Për të lehtësuar zbatimin, është hartuar dhe bashkëngjitur një *Plan i veçantë i Veprimit* (Shtojca 1). Komuna do të mundësojë *monitorimin periodik të zbatimit* të tij. Përgjegjësitë për monitorimin e rregullt të Planit i janë caktuar _____. Raportimi i rregullt do të sigurojë që implementimi i Planit të bëhet sipas kalendarit dhe të arrihen rezultatet e planifikuara. _____ do të jetë përgjegjës për të raportuar në baza periodike te Kryetari i Komunës lidhur me zbatimin. Shpeshtësia minimale e raportimit është brenda periudhën gjashtë mujore. Raportimi i mundëson Kryetarit që të ndërmarrë me kohë masat korrigjuese/parandaluese në rast se zbatimi i ndonjë mase/masave të caktuara paraqet vështirësi/vonesa.

Plani i Integritetit duhet të përmbajë, në veçanti:

- **Deklaratën e Integritetit** e cila rithekson përkushtimin për integritet të Komunës së Mamushës.
- **Planin e Integritetit** që shpjegon historikun, fushëveprimin, qëllimin, objektivat dhe metodologjinë.
- **Objektivat strategjike, linjat e aktiviteteve dhe masat** përcaktojnë objektivat kyçe strategjike dhe fushat e veprimit që synojnë fuqizimin e mbrojtjes së integritetit në Komunën e Mamushës. Këto bazohen në rreziqet e vlerësuara të integritetit, mësimet e nxjerra dhe praktikrat e mira përkatëse. Plani ofron arsyetim/justifikim për linjat e aktiviteteve të planifikuara, të mbështetura më tej me masa të synuara në udhëheqjen e procesit të implementimit.
- **Planin e Veprimit** përcakton në hollësi të gjitha masat që duhen ndërmarrë për të arritur objektivat e caktuara, si dhe kornizën kohore përkatëse dhe përgjegjësitë organizative për implementim. Janë definuar indikatorët e suksesit për secilën masë, të mbështetura me resurset e nevojshme financiare.

Plani i Integritetit shihet si baza strategjike për të përmirësuar më tej sistemin e menaxhimit të integritetit në Komunën e Mamushës (në tekstin në vijim referuar si SMI). Sistemi i tillë konsiderohet çelës i zvogëlimit të kostove të konsiderueshme ekonomike dhe njerëzore të shkeljeve të integritetit, avancon punën e ardhshme dhe rritjen e reputacionit dhe besueshmërisë së organizatës. Planifikimi i integritetit mbetet shtylla e tij themelore.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE, LINJAT E AKTIVITETEVE DHE MASAT

Komuna e Mamushës ka azhurnuar proceset e saja me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të operacioneve, modernizimin e shërbimeve dhe përforcimin e vazhdueshëm të qasjes me klientin në qendër në përputhje me sfidat dhe mundësitë të cilat udhëheqin agjendën kosovare të modernizimit të administratës publike. Duke u mbështetur në arritjet e saj deri më tani dhe e frymëzuar nga agjenda kombëtare kundër korrupsionit dhe nga praktikatat e suksesshme ndërkombëtare, administrata do të avancojë më tej praktikatat e menaxhimit të integritetit duke u përqendruar *në tri fusha kryesore*, si në vijim:

- **Përmirësimi i mëtejshëm i politikave të rrezikut të integritetit dhe administrimit të rrezikut të integritetit për të ofruar një politikë dhe një kornizë institucionale të përshtatshme për komunën, në mënyrë që të menaxhojë në mënyrë efektive rrezikun e integritetit, për të zvogëluar potencialin për shkeljet dhe për të përmirësuar performancën e integritetit;**
- **Forcimi i mbrojtjes së integritetit në proceset kritike dhe në zonat e operimit;**
- **Nxitja e çiltërsisë dhe transparencës dhe mobilizimit të kapaciteteve të akterëve të jashtëm për të vepruar si bashkëpronarë në reformat e integritetit për të mirën e komunitetit.**

Në vijim paraqiten dhe shpjegohen objektivat e lartpërmendura strategjike dhe këto objektiva përkthehen në linja të aktiviteteve konkrete të politikave dhe menaxhimit dhe në masa që përkrahin arritjen e tyre.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1:

Përmirësimi i mëtejshëm i politikave të rrezikut të integritetit dhe administrimit të rrezikut të integritetit për të ofruar një politikë dhe një kornizë institucionale të përshtatshme për komunën, në mënyrë që të menaxhojë në mënyrë efektive rrezikun e integritetit, për të zvogëluar potencialin për shkeljet dhe për të përmirësuar performancën e integritetit.

Linjat e aktivitetit dhe masat përkatëse

- 1.1. Të ruaj dhe përditësojë politikatat e rrezikut të integritetit në përputhje me prioritetet aktuale strategjike të Komunës së Mamushës, aspektet kryesore të modernizimit të administratës publike të Kosovës dhe standardeve më të mira në kundër-korrupsion dhe integritetin

Arsyetimi: Lidershipi është i një rëndësie qendrore për arritjen e suksesit të shumë strategjive, veçanërisht ato që lidhen me zhvillimin organizativ dhe integritetin. Vlerat organizative dhe respektimi i standardeve të larta profesionale të shërbimit nuk do të pranohet dhe ndiqet nga zyrtarët komunal nëse nuk demonstronhet nga zyrtarët në pozita udhëheqëse. Liderët etik me politika proaktive të rrezikut të integritetit nxisin sjelljen etike si normë organizative. Kështu që, lidershipi është i rëndësishme në të gjitha nivelet e komunës dhe duhet të fuqizohet përmes një politike të dukshme dhe të qëndrueshme të rrezikut, që është komunikuar dhe i njohur për të gjithë stafin. Për të qenë efektive, politika e tillë e riskut duhet të trajtojë rreziqet e identifikuar dhe problemet e veçanta. Për të qenë e qëndrueshme dhe e ndjeshme ndaj çështjeve dhe zhvillimeve të rëndësishme të sistemit, duhet të jetë në përputhje me prioritetet kryesore të agjendës së Kosovës për modernizimin e administratës publike. Për të qenë inovative, ajo duhet të marrë parasysh arritjet më të mira aktuale në fushën e menaxhimit të integritetit, të bazuara mbi mësimet e nxjerra dhe përshtatura për të nxitur kontekstin lokal.

1.1.1. Të demonstrojnë lidership në çështjet e integritetit komunal nëpërmjet organizimit/përgatitjes në mënyrë adekuate me qëllim të *implementimit* të vazhdueshëm dhe në kohë të *Planit të Integritetit*, si dhe *raportimin, rishikimin dhe përditësimin e tij në baza periodike*. Kjo e fundit duhet të bëhet në një format të strukturuar dhe të informuar, bazuar në rivlerësimin e rreziqeve dhe cenueshmërive të identifikuar, sipas nevojës, si dhe në fund të periudhës së planifikimit.

1.1.2. Të synohet rritja e dukshmërisë së përpjekjeve të integritetit të lidershipit aktuale të komunës në të gjithë komunën, vendos një sistem të strukturuar për të përfshirë *çështjet e integritetit të ndërlidhura me agjendën e dëgjimeve publike, seancave publike dhe takimeve periodike të menaxhmentit të lartë*. Për të fituar partnerë në reforma, miratohet dhe mbahet një politikë e përfshirjes progresive të një game më të madhe të akterëve të brendshëm dhe të jashtëm në diskutimin e rreziqeve të integritetit dhe masave të integritetit, që përfshinë këshilltarët Komunal dhe palët kryesore të interesit.

1.2. Të forcohet më tej sistemi i menaxhimit të integritetit si një kornizë e qeverisjes për të siguruar se politika e rrezikut është arritur dhe menaxhimi efektiv i rrezikut është zbatuar

Arsyetimi: Për të siguruar arritjen e objektivave të politikave të integritetit, Komuna ka nevojë për një kornizë të përshtatshme të qeverisjes që në mënyrë specifike mbështet politikën e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut. Kjo kërkon një sistem të menaxhimit funksional dhe adekuat të integritetit. Ky sistem i shërben planifikimit të masave të integritetit në Planin e Integritetit, por

gjithashtu mundëson zbatimin e tij, monitorimin dhe matjen e karakteristikave kryesore të operacioneve që përcaktojnë performancën e integritetit. Mbulon ndërmarrjen e veprimeve pasuese me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së integritetit dhe të sistemit për menaxhimin e integritetit. Aktualisht, Komuna e Mamushës demonstroi elementet kryesore të një sistemi të tillë, megjithatë, shtyllat dhe ndërlidhjet e saj ende duhet ndërtuar/fuqizuar në përputhje me përvojat e mira dhe standardet në mbrojtjen e integritetit. Ky Plan i Integritetit përfshin masa të rëndësishme në drejtimin e mësipërm. Edhe pse ky është një sistem plotësisht i përkushtuar për menaxhimin e integritetit, nuk është zgjidhje për të gjitha çështjet e integritetit që mund të lindin në kontekstin komunal, prapëseprapë është i rëndësishëm në zvogëlimin e mundësive për korrupsion dhe cenueshmëri në sistemin e qeverisjes. Sistemi ofron mundësi për rishikimin e proceseve, ri-projektimin e procedurave dhe përforcon besimin dhe përkushtimin kolektiv për siguruar përputhshmërinë me detyrimet ligjore dhe zotimet etike.

- 1.2.1. *Të bëhet ndarja e qartë e roleve dhe përgjegjësi në aspektin e përmbushjes së funksionit të integritetit në Komunën e Mamushës, përfshirë përgjegjësinë dhe autoritetin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit si dhe raportimet e ndërlidhura me të. Vetëdijesimin e stafit se çdonjëri prej tyre është menaxher i rrezikut të integritetit dhe se ka përgjegjësi të mëdha në lidhje me integritetin, brenda fushës së kompetencës dhe përgjegjësisë së tij/saj. Të marrë parasysh futjen e një sistemi të këshillimit etik nëpërmjet emërimit të një këshilltari të etikës, me autoritet, kredibilitet dhe status për të qenë i/e besueshëm nga ana e stafit dhe t'iu ndihmojë atyre në zgjidhjen e dilemave të etikës.*
- 1.2.2. *Të përditësohet konsiderueshëm familjarizimi i gjithë stafit me instrumentet kyçe në menaxhimin dhe mbrojtjen e integritetit, e cila përfshinë, por nuk kufizohet në Kodin ekzistues të Etikës dhe rregulloren normative për Konflikt të Interesit, dhuratat, punësim dytësor, deklarament të detyrueshëm. Për këtë qëllim, të merren parasysh formatet e trajnimit dhe vetëdijesimit sipas nevojës, si dhe testimin periodik të njohurive të punonjësve. Trajnimi i tillë duhet që qartazi të mbulojë pritshmërinë e gjithë punonjësve në lidhje me (1) obligimin që kanë në komunikimin e disa çështjeve; (2) listën e llojeve të çështjeve, duke përfshirë shkeljet ose dyshimet për shkelje të integritetit, që komunikohen së bashku me shembujt konkretë; dhe (3) informimin mbi mënyrën se si duhet komunikuar këto çështje.*
- 1.2.3. *Të sigurohet se ekzistenca e Regjistrit të Dhuratave në Komunën e Mamushës, të mirëmbahet sipas nevojës dhe se i gjithë stafi është në dijeni për ekzistencën e këtij regjistri.*

1.2.4. *Të forcohen njohuritë dhe aftësitë e menaxhmentit të mesëm dhe të lartë në politikat e rrezikut dhe menaxhimit të rrezikut të integritetit* nëpërmjet formateve të duhura të trajnimit, vetëdijesimit dhe komunikimit. Të sigurohet që të menduarit e bazuar në rrezik të bëhet gradualisht bazë për vendimmarrjen e informuar, shkrimin e procedurës, si dhe zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve operative të integritetit. Për këtë qëllim, të inkurajohet pjesëmarrja e menaxhmentit të lartë dhe të mesëm në rrjetet, konferencat, tryezat e rrumbullakëta dhe projektet përkatëse të praktikuesve. .

1.2.5. Të krijohet një mekanizëm i mirë projektuar dhe funksional *për raportimin e brendshëm* të sjelljes abuzive, e i cili promovohet si një instrument parandalimi. Të rritet familjarizimi i stafit me çështjet *e mbrojtjes së informatorëve*, përfshirë rregulloret dhe procedurat, në mënyrë që secili të kuptoj rëndësinë e veçantë të informimit dhe të veprtojë në përputhje me rrethanat, nëse dhe ku është e nevojshme. Të sigurohet që mbrojtja e informatorëve në komunë është e organizuar mirë. Të sigurohet që incidentet e lidhura me integritetin, janë identifikuar, regjistruar, raportuar sipas rastit, si dhe janë hetuar, analizuar dhe vlerësuar plotësisht për nevoja të veprimit të mëtejshëm, dhe që udhëheqja komunale të identifikoj veprimet e hershme. Të rishikohen kontrollet e brendshme pas zbulimit të një mashtrimi ose korrupsionit. Të kontrollohet zbatimi konsistent i procedurave disiplinore për incidentet e zbuluara, të dokumentohen dhe komunikohen këto kontrole. Të raportohen dhe publikohen trendët në baza vjetore.

1.2.6. Të rritet vetëdijesimi i stafit për rëndësinë e *monitorimit të implementimit të Kodit të Etikës* në Komunën e Mamushën. Për këtë qëllim, të familjarizohet stafi me kriteret e monitorimit të zhvilluara nga qeveria qendrore e të cilat duhet të aplikohen në kontekstin e Kodit të Etikës. Të aftësohen dhe zhvillohen kapacitetet e personave përgjegjës për monitorimin e parimeve të etikës dhe transparencës në komunë.

1.3. Të përmirësohen praktikat e menaxhimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore, për t'u siguruar që stafi është i përgatitu mirë dhe i vetëdijshëm për rolin që ka në menaxhimin e integritetit.

Arsyetimi: Performanca e zyrtarëve komunal në lidhje me respektimin e vlerave etike dhe standardeve profesionale mbesin një parametër i rëndësishëm i sistemit të implementuar për menaxhimin e integritetit. Prandaj, duhet të ndërmerret kujdesi i duhur për të siguruar që proceset jo vetëm që kanë staf adekuat me njerëz të duhur për punë, por edhe tërë stafit i

jepet mundësia që të mbrojnë në mënyrë efektive sistemin kundër shkeljeve të integritetit. Vlerësimi i rrezikut i kryer në Komunën e Mamushës ka treguar nivel të lartë të vetëdijesimit të gjithë stafit në lidhje me rëndësinë kritike të proceseve të MBNj dhe ZhBNj. Nëse këto të fundit si tërësi ofrojnë rezistencë të fortë ndaj shkeljeve të integritetit, fushat në vijim janë vërejtur se kanë nevojë për përmirësim të mëtejshëm: vërtetimi dhe vlerësimi i performancës; përzgjedhja dhe rekrutimi i stafit; sistemi i trajnimit, vizitat studimore jashtë vendit, sistemi i shpërblimit financiar, zhvillimi i karrierës. Meqë, masat e mundshme në lidhje me integritetin të cilat mund të ndihmojnë në rritjen e integritetit në proceset e përzgjedhjes dhe rekrutimit, masat në vijim janë konsideruar të duhura: kriteret e qarta dhe transparente të përzgjedhjes për të parandaluar favorizimin dhe nepotizmin; procedura e brendshme e shkruar për përzgjedhjen dhe rekrutimin e stafit; auditimi i dokumentuar qartazi mbi punën e komisionit të përzgjedhjes; kohëzgjatja e arsyeshme kohore për përgatitjen e dokumenteve dhe paraqitjen e aplikacionit për punë, deklaratat e nënshkruara për Konflikt të Interesit e të gjithë anëtarëve të komisionit; vërtetimi i kualifikimeve dhe diplomave para rekrutimit. Mundësitë për përmirësim të sistemit për zhvillimin e karrierës janë vërejtur në: kriteret e qarta dhe transparente për zhvillim të karrierës, të krijuara dhe përcjella në vazhdimësi; procedurat e qarta të brendshme për zhvillimin e karrierës; auditimet e jashtme për procedurat e zhvillimit të karrierës, sistemin transparent të shkallës së pagesës dhe përfitimeve; sistem të përditësuar të ankesave për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive ankesave lidhur me abuzimin e procedurave për zhvillimin e karrierës, auditimeve ad hoc për respektimin e rregullave. Për sa i përket vlerësimit, mundësitë për përmirësim të mëtejshëm janë vërejtur në: procedurën e brendshme të shkruar për vlerësimin e stafit; kriteret e qarta dhe transparente të vlerësimit për të parandaluar favorizimin dhe nepotizmin; auditim i dokumentuar qartazi për procesin e vlerësimit; mundësinë për të marrë këshilla nga dhe raportoje tek këshilltari i integritetit mbi të metat e procesit të vlerësimit. Mundësitë për të përmirësuar sistemin e ZhBNj janë vërejtur në: transparencën e rritur për mundësitë e trajnimit, kriteret e qarta dhe transparente për zgjedhjen konkurruese të trajnerëve; auditim të qartë dhe raportim të rezultateve të trajnimit; vlerësimin e efektivitetit të trajnimit.

- 1.3.1. Të shqyrtohen mundësitë për futjen dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Shërbimin Civil (SIMBNj) – i krijuar dhe menaxhuar nga Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil (MAP), dhe që të zgjerohet edhe më tej në të gjitha institucionet e administratës publike në nivel lokal. Kjo do t'i mundësoj Komunës së Mamushës që të planifikojë dhe monitoroj implementimin e politikave në shërbimin civil. Të sigurohet saktësia e informacionit.*

- 1.3.2. Të sigurohet *mos diskriminimi, trajtimi i drejtë dhe barazia gjinore* në të gjitha praktikrat dhe procedurat komunale. Për këtë qëllim, të rishikohen politikat aktuale gjinore në mënyrë që të ofrohet mbrojtje e mjaftueshme dhe të zhvillohet një politikë që inkurajon pjesëmarrjen e grave në pozitat e larta menaxhuese. Progresi i arritur të matet në baza periodike.
- 1.3.3. Të plotësohen në mënyrë adekuate funksionet e MBNj dhe ZhBNj me *staf* të kualifikuar. Të përdoret çdo burim i jashtëm në dispozicion (p.sh. IKAP, trajnimet e bazuara në projekt) për të përmirësuar më tej kapacitetet aktuale.
- 1.3.4. Të merret parasysh përmirësimi i *proceseve komunale të rekrutimit nëpërmjet* rritjes së transparencës dhe kontrolleve të përmirësuara. Për këtë qëllim, të krijohen standarde minimale të transparencës në rekrutimin dhe të monitorohet dhe raportohet për zbatimin e tyre. Të lejohet kohë e mjaftueshme për aplikimin, përgatitjen dhe dorëzimin e dokumenteve. Të merret parasysh kontrollimi i kualifikimeve të kandidatëve për pozitat e ndjeshme me rrezik të lartë.
- 1.3.5. Të eksplorohej arsyeshmëria dhe të inkurajohet implementimi i *sistemit të ri të performancës* i cili duhet të miratohet në mënyrë qendrore në Kosovë. Kjo do të ndihmojë në lëvizjen dhe promovimin e bazuar në kritere objektive dhe transparente dhe në merita. Të ruhet niveli i duhur i transparencës së funksionimit të sistemit.
- 1.3.6. Të forcohen kontrollet mbi *menaxhimin e orëve të punës*: p.sh. të merret parasysh përdorimi i sistemit për regjistrimin e orëve të punës; sistemi i ankesave, etj.
- 1.3.7. Të fuqizohen masat kontrolluese për *menaxhimin e udhëtimeve zyrtare* të sigurohet që të gjitha udhëtimet zyrtare të bëhen në bazë të kriterëve të pranuar të përkufizuara mirë, të jenë transparente dhe në përputhje me kushtet.
- 1.3.8. Të inicohet *anketa periodike për monitorimin e kënaqshmërisë së stafit* me punën dhe mjedisin e integritetit si një "sistem i paralajmërimit të hershëm" për identifikimin e problemeve dhe tendencave.
- 1.3.9. Të merret parasysh përmirësimi i aftësisë profesionale duke ndërlidhur në mënyrën e duhur vlerësimin e nevojave për trajnim, mbajtjen e trajnimit dhe vlerësimin e efikasitetit. Të sigurohet që trajnimi të mbahet në bazë të nevojave.

- 1.3.10. Të fuqizohen mekanizmat monitorues dhe kontrollues për të siguruar që *mundësitë për trajnim i komunikohen siç duhet dhe me kohë* të gjithë stafit. Për këtë qëllim, të merret parasysh prezantimi i një procedure të strukturuar me rregulla të qarta të transparencës, masa kontrolluese, përgjegjësi dhe mekanizma raportues.
- 1.3.11. Të merret parasysh krijimi i *linjës telefonike pa pagesë posaçërisht për çështje që ndërlidhen me MBNj dhe ZhBNj*. Të analizohen dhe raportohen tendencat tek menaxhmenti i lartë përgjegjëse.

1.4. Të përmirësohet konsiderueshëm dhe ndjeshëm sistemi i koordinimit dhe komunikimit të brendshëm

Arsyetimi: Për të siguruar përmbushjen e objektivave të politikës së integritetit, Komunës i nevojitet një sistem i përshtatshëm i koordinimit dhe komunikimit të brendshëm. Një sistem i tillë jo vetëm që i lidh departamentet dhe njerëzit, por gjithashtu krijon një profil të veçantë të çiltërsisë, pjesëmarrjes dhe frymës së përbashkët në organizatë përkritazi me çështje të integritetit. Vendimmarrja e informuar dhe zbatimi efektiv i politikave dhe vendimeve bazohet në të kuptuarit e përbashkët të sfidave/detyrave, si dhe në synimet dhe vlerat e përbashkëta. Rrjedhimisht, mangësitë në sistemin e komunikimit dhe koordinimit mund të çojnë në mosshfrytëzimin ose humbjen e rasteve për të shfrytëzuar potencialin individual ekzistues në arritjen e së mirës së përbashkët.

- 1.4.1. Të plotësohet me stafin adekuat *funksioni i komunikimit dhe marrëdhëniet me publikun* në Komunën e Mamushës. Në këtë drejtim, të merren parasysh *nevojat më se urgjente për të mbështetur siç duhet funksionin e TI-së* me qëllim të që mundësohet qasje më e lehtë në TIK dhe kështu të mundësohet shkëmbimi i informatave dhe të dhënave në të gjitha nivelet.
- 1.4.2. Të sigurohet që integriteti të bëhet pjesë e zakonshme e sistemit të brendshëm të komunikimit ashtu që çështjet dhe zhvillimet që ndërlidhen me integritetin të diskutohen rregullisht dhe të nxiten qëndrime proaktive. Të shqyrtohen kanalet e përshtatshme të komunikimit të tillë për të rritur përhapjen dhe për të siguruar rritjen e vetëdijesimit. Sipas nevojës të krijohet/mirëmbahet/përmirësohet vazhdueshëm *sistemi digjital i komunikimit të brendshëm* duke përdorur infrastrukturën e TI me qëllim që të mundësohet shkëmbimin më efikas i të dhënave dhe komunikimit ndërmjet njësive.

1.4.3. Të përmirësohen dhe formalizohen më tej procedurat për *koordinim* të brendshëm vertikal dhe horizontal, si dhe për koordinim të jashtëm me kategori të ndryshme të akterëve: qeveria qendrore, komunat, bizneset, OJQ-të, etj. Të merret parasysh optimalizimi i sistemit për aranzhimin e takimeve menaxheriale në nivele më të ulëta me qëllim të decentralizimit të detyrave tek të gjitha njësitë. Sipas nevojës të krijohet/mirëmbahet/përmirësohet vazhdueshëm *sistemi digjital i komunikimit të brendshëm* duke përdorur infrastrukturën e TI me qëllim që të mundësohet shkëmbimin më efikas i të dhënave dhe komunikimit ndërmjet njësive.

1.5. Të krijohet dhe mirëmbahet një sistem efektiv i auditimit dhe kontrollit si shtyllë kryesore për funksionimin e sistemit për menaxhimin e integritetit

Arsyetim: Asnjë sistem për menaxhim nuk mund të funksionojë me efikasitet dhe të sigurojë në masë të arsyeshme përmbushjen e objektivave të vëna pa një shtyllë të përshtatshme, të strukturuar mirë, me burimet e nevojshme dhe llogaridhënese të auditimit dhe kontrollit. Ajo jo vetëm që e mundëson hetimin e rasteve të korrupsionit, por gjithashtu nxjerr në pah dobësitë, duke mundësuar kështu trajtimin e tyre në fazat e hershme dhe para se të vije deri te rreziqet. Në Komunën e Mamushës, ndërtimi dhe fuqizimi i këtij sistemi është ende në fazat e hershme. Megjithëse njihet rëndësia e auditimit, komunës ende i mbetet të zhvillojë kapacitetet e veta të brendshme në fushën e auditimit, si dhe të kompletojë kornizën e duhur politike, rregullative dhe operative. Vlerësimi i rrezikut e bën të qartë që roli i përkatës i kornizës së auditimit dhe kontrollimit të brendshëm është i njohur për personelin. Megjithatë, e ardhmja do të paraqesë sfida. Në këtë drejtim, kontrolli i shtuar mbi rezultatet e auditimit, profesionalizmi i shtuar i ekipit të auditimit, auditimet *ad hoc* (të papritura/të paplanifikuara), shpeshtësia e shtuar dhe dokumentimi i qartë i auditimit shihen si masa të përshtatshme kontrolluese operative që mund ta rrisin efikasitetin e procesit të auditimit sa i përket integritetit.

1.5.1. Të plotësohet përshtatshëm funksioni i auditimit duke e promovuar auditimin si shtyllë kryesore të mbrojtjes së integritetit. Të merret parasysh punësimi i një auditori të brendshëm dhe të sigurohet përshkrimi i hollësishëm i vendit të punës. Të rriten kapacitetet profesionale të auditimit të brendshëm për t'u marrë me kërkesat e përditësuara të instrumenteve të auditimit. Të shqyrtohen mundësitë për rritjen e stimuljeve për punë për auditorët në kuadër të sistemit aktual të shpërblimit, për shembull të punohet për koeficientin e rrezikut, si dhe duke ofruar mundësi për ngritjen e kapaciteteve.

- 1.5.2. Të rishikohen politikat dhe procedurat aktuale të brendshme që ndërlidhen me auditimin e brendshëm. Të shqyrtohen mundësitë për ofrimin e një *PSO-je të qartë* që mbulon *të gjitha fazat/hapat*: kërkesat e dokumentimit dhe raportimit; ndarja e përgjegjësiwe përkatëse. Fokusi të jetë në menaxhimin e rrezikut, veprimet e veçanta kontrolluese, planifikimin e auditimit të brendshëm, ndarjen e burimeve për auditimin e brendshëm, vlerësimi i performancës së auditimit të brendshëm dhe sigurimi i cilësisë.
- 1.5.3. Të rishikohet *sistemi aktual i planifikimit të auditimit* për të kapur mundësitë që planifikimi i auditimit të bazohet në vlerësimin e rrezikut, i cili përqendrohet në rreziqet e mashtrimit dhe korrupsionit në nivelet e larta. Të rritet shpeshtësia dhe llojet e auditimeve. Të sigurohet monitorimi i zbatimit të planit të auditimit, me masat e nevojshme korrigjuese, sipas nevojës.
- 1.5.4. *Të fuqizohet dhe strukturohet më tej kontrolli mbi zbatimin e të gjeturave/rekomandimeve të auditimit*. Në këtë drejtim, të merret parasysh krijimi i një databaze që përcjell zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe regjistron përparimin e bërë në zbatimin e tyre dhe funksionon si instrument unik për menaxherët publik që të mund të monitorojnë dhe vlerësojnë veprimet e brendshme kontrolluese.
- 1.6. Të praktikohet përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, të forcohet efikasiteti, efektiviteti, transparencja dhe llogaridhënia e pushtetit lokal, duke zvogëluar kështu mundësitë për keqpërdorimin e integritetit dhe të standardeve profesionale**

Arsyetim: Menaxhimi efektiv i integritetit është i pandashëm nga ruajtja e cilësisë, llogaridhënies, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit të funksionimit. Në mbarë botën, pushtetet lokale gjithnjë e më shumë po përdorin instrumente të bazuara në TQM për të përmirësuar performancën e tyre deri në nivelin më të lartë të përmbushjes së nevojave dhe pritjeve të klientëve. Këto përfshijnë, ndër të tjera, rishikimet funksionale, zbatimin e standardeve ISO, si ISO 9001 që i parasheh kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë, skemat e përsosmërisë të tilla si Korniza e Përbashkët e Vlerësimit (KPV) dhe EFQM, Kartat për shërbim të qytetarëve, etj. Respektimi i standardeve ndërkombëtare do të ofrojë në mënyrë konsistente një kornizë të brendshme që përfshin përqendrim të fuqishëm te konsumatori dhe bazohet te proceset dhe rreziqet. Pranimi përmes certifikimit (ISO 9001) ose regjistrimit dhe verifikimit (KPV dhe EFQM) ofron stimuj dhe shpërblim shtesë për personelin në pushtet lokale. Kartat e qytetarëve përcojnë një mesazh të fuqishëm për klientët e brendshëm dhe të jashtëm për përkushtimin e qartë të menaxhmentit ndaj integritetit dhe shërbimit me klientin në qendër dhe transparent.

- 1.6.1. Më tej, sipas agjendës kombëtare të modernizimit, të miratohet *Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe klasifikimin e vendeve të punës, si dhe sistematizimin e tyre*, bazuar në katalogun e vendeve të punës të miratuar nga qeveria. Të shqyrtohet *struktura organizative* për të siguruar që përfshin qartë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha pozitat, si dhe linjat përkatëse të përgjegjësisë dhe llogaridhënies për të arritur transparencën dhe efikasitetin maksimal të funksionimit. Të vazhdohet përshtatja e vendeve të punës me përgjegjësitë që burojnë nga rregullorja e re për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në institucione dhe me modelin e përcaktuar në katalogun e vendeve të punës.
- 1.6.2. Me qëllim të zhvillimit një *sistemi të menaxhimit të bazuar në procese*, të identifikohen proceset kryesore strategjike, operative dhe mbështetëse, të radhiten ato në *Regjistrin e proceseve komunale* dhe të shqyrtohet se si do të përfshihen ato në PSO-të përkatëse dhe udhëzime të tjera operative. Kur gjenden defekte kritike, të merret parasysh zhvillimi i procedurave për zvogëlimin e rrezikut të gabimeve, shmangieve dhe shkeljeve të integritetit. *T'i komunikohen këto procedura të gjithë stafit të përfshirë. Të aftësohet stafi sipas nevojës.*
- 1.6.3. Në harmoni me Rregulloren për organizimin e brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës, strukturën organizative dhe procedurat operative, të *rishikohen dhe përkatësisht harmonizohen përshkrimet ekzistuese të vendeve të punës. T'i komunikohen stafit sipas nevojës.*
- 1.6.4. Të rriten përpjekjet drejt futjes/mbajtjes së *ofrimit të shërbimeve miqësore për përdoruesin dhe me klientin në qendër*. Të shqyrtohen praktikat më të mira dhe dokumentet strategjike kombëtare, dhe bazuar në mësimet e marra, të prioritetëve strategjike të *merret parasysh zbatimi progresiv i një ose më tepër instrumentesh që kanë dëshmuar rritje të efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve*, duke përfshirë ISO 9001:2015, kornizën e vlerësimit të përbashkët, skemën e përsosmërisë EFQM, Kartat e shërbimeve për klientë, etj.
- 1.6.5. Të përmirësohen në mënyrë të dukshme *mekanizmat për matjen e opinionit publik rreth cilësisë së shërbimeve të ofruara nga Komuna e Mamushës*. Sipas nevojës, të planifikohen dhe realizohen anketa për kënaqshmërinë e klientëve; të ndërmerren veprime me anë të metodës “pala e fshehur”, etj. Të sigurohen analiza periodike (dyvjeçare dhe vjetore) të sinjaleve, sugjerimeve dhe ankesave që kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimeve dhe zbatimin e standardeve profesionale në kontekst të Komunës.

1.7. Të përvetësohet në mënyrë progresive siguria e informacionit si një fushë kyçe e mbrojtjes, jetike për mbështetjen e integritetit dhe fuqizimin e qëndrueshmërisë

Arsyetimi: Siguria e informacionit gjithnjë e më shumë është duke u bërë një fushë kyçe e ndërhyrjes, e lidhur me cënueshmëritë, ndikimet dhe rreziqet e ndërlidhura kritike. Vlerësimi i rrezikut, i realizuar në komunën e Mamushës, tregon qartë se mbrojtja e sigurisë të informacionit në Mamushë, ngjashëm me vendet tjera në Kosovë, paraqet një sfidë serioze. Kjo fushë duhet të adresohet urgjentisht, duke pasur parasysh mangësitë në caktimin e burimeve për funksionimin e TI-së në Komunë, nivelin e lartë të kërcënimeve ndaj integritetit që janë të përfshirë, si dhe mungesën e efikasitetit të kontrollit ekzistues. Shqetësimi adekuat në lidhje me sfidat e sigurisë së informacionit në mënyrë efektive do t'i kufizojë mundësitë për shkelje të integritetit.

1.7.1. Të shqyrtohet kontraktimi i funksionit të menaxhimit të sigurisë së informacionit duke punësuar stafin e duhur dhe zhvillimin e një TeR gjithëpërfshirës. Të sigurohet njohuria dhe ekspertiza adekuate në këtë fushë.

1.7.2. Të promovohet mbrojtja e sigurisë së informacionit si fusha kyçe brengosëse. Të përmirësohet ndjeshëm të kuptuarit e menaxhimit kyç e rëndësishme për të garantuar sigurinë e informacionit si një aset kyç të komunës. Për këtë qëllim, të sigurohet ngritja e kapaciteteve përkatëse dhe të inkurajohet pjesëmarrja e lidershit komunal dhe e menaxhmentit të lartë dhe të mesëm në forume përkatëse në Kosovë dhe jashtë vendit. Ngritja e njohurive dhe e ndërgjegjësimit të të gjithë stafit sa i përket rreziqeve të integritetit që lidhen me sigurimin e informacionit dhe shfrytëzimin e burimeve kompjuterike, në mënyrë të veçantë - kontrollin e qasjes.

1.7.3. Të fuqizohet kontrolli operacional në mbrojtjen e sigurisë së informacionit, më tej përpos asaj në kuadrin e referencës të formësuar sipas standardeve ndërkombëtare në dispozicion: Udhëzimet e OECD-së mbi Sigurinë e Informacionit dhe Rrjeteve, dhe standardeve të menaxhimit ISO/IEC 27001. Të shqyrtohet, ndër të tjera, përdorimin e rregullimit të konfidencialitetit, termat dhe kushtet e përdorimit të kompjuterit, përtëritjes së fjalëkalimit, klasifikimeve, skanimit të postës së pranuar, auditimin dhe raportet e veçanta, anulimin automatikisht i qasjes kur ndërpritet punësimi. Të ndahen përgjegjësitë në lidhje me zbatimin e tij, si dhe burimet e nevojshme.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2:

Fuqizimi i mbrojtjes së integritetit në proceset kritike dhe fushat e veprimit

Arsyetimi: Vlerësimi i rrezikut, i realizuar në Komunën e Mamushës ka marr parasysh proceset e rëndësishme strategjike, operative dhe mbështetëse, me qëllim që të identifikojë fushat relevante të përmirësimit/masave që mëndohet se kontribuojnë më së shumti në minimizimin e cenueshmërisë, duke përmirësuar mbrojtjen dhe fuqizuar qëndrueshmërinë. Sa i përket rreziqeve të mëdha të integritetit në kuadër të funksioneve kryesore të komunës, përmirësimet në kontroll janë të nevojshëm për fushat e mëposhtme (listuar sipas niveleve të rrezikut: nga ai i lartë tek më i ulët): për zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollin e ndërtimit; licencimin e shërbimeve lokale dhe lehtësirave; planifikimit urban dhe rural; shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin; shëndetin publik; ofrimin e kujdesit parësor shëndetësor publik; ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe komunale; mbrojtjen e mjedisit lokal; ofrimin e arsimit publik para fillor, fillor dhe arsimit të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, rekrutimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit; banimin publik; zhvillimin ekonomik lokal. Ndër kompetencat e deleguara të komunës më të rrezikuara nga shkeljet e integritetit (me rrezik për korrupsion) janë vlerësuar të jenë: shënimet kadastrale; regjistrimi i votuesve; regjistrat civil; mbrojtja e pyjeve në territorin e komunës. Kërcënime të mëdha sa i përket mbrojtjes së integritetit janë parë në fushat vijuese: kontratat blerëse/prokurim; menaxhimin financiar/përdorimin e burimeve monetare publike/keqpërdorimi dhe vjedhja; buxhetet dhe menaxhimi i buxhetit; ofrimi i shërbimeve - organizimi i ofrimit të shërbimeve; pjesëmarrja në projekte; banimi; përdorimi i automjeteve publike. Gama e gjerë e rreziqeve dhe cenueshmërisë së mundshme e përmendur më lart tregon nevojën për të strukturuar mire dhe ndarë në faza agjendën e reformave, e cila do të nxirret nga ky Plan. Në disa fusha, ku ka politika dhe procedura përkatëse, duhet të fuqizohen mekanizmat e zbatimit, mbështetur nga ngritja e kapaciteteve të nevojshme, ngritja e ndërgjegjësimit dhe monitorimi i kontrolleve ekzistuese. Në fushat ku mbrojtja duket paksa më e dobët, kjo platformë veprimi së pari do të duhej të adresojë zhvillimin e politikave dhe procedurave të përshtatshme, si dhe caktimin e burimeve adekuate të funksioneve themelore, që sigurojnë mbrojtje të besueshme. Mbështetja e tepërt në rregulla normative në nivel të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, pa elaboruar mjedisin e brendshëm rregullativ të nevojshëm në nivel të procedurave të punës, udhëzimeve, etj mund të përbëjë një rrezik të ri që shfaqet meqë komuna do të mbetet me mburojë të përgjithshme, pa pasur procedura të nevojshme zbatuese që do lehtësojnë më tej zbatimin në kontekstin lokal. Përzgjedhja e masave specifike/metodave të kontrollit varet nga një numër faktorësh, siç janë aftësitë dhe përvoja

e personave që kryejnë operacionin si dhe kompleksiteti dhe rëndësia e integritetit të vetë operacionit. Në këtë kontekst lokal, kostot e veprimeve ose mos-veprimit duhet të balancohen me kujdes për të siguruar nivelin e mbrojtjes optimale të mundshme. Vlerësimet tjera të rrezikut mund të sjellin potencial shtesë për reforma, duke sugjeruar linja të reja të aktivitetit dhe masave.

Linjat e aktivitetit dhe masat përkatëse për proceset dhe fushat e veprimit:

Procedurat administrative

2.1.1. Të përmirësohet ndjeshëm sistemin *ekzistues për menaxhimin e kontrollit të dokumenteve*. Për këtë qëllim, të shqyrtohen mundësitë dhe të merret parasysh zbatimi i *Sistemit për Menaxhimin e Dokumenteve Elektronike*, i cili është duke u zhvilluar/pilotuar në nivel qendror në Kosovë. Kjo do të sjellë standardizim në proceset e mbajtjes së shënimeve elektronike në gjithë komunën, do të përmirësoj shkëmbimin e informacionit ndërmjet stafit, dhe përdoruesve, shpërndarjen elektronike dhe monitorimin e dokumenteve; përpunimin elektronik të peticioneve, krijimin e një ndërfaqeje (aplikacioni) elektronike për marrjen e informacionit lidhur me peticionet e ndërlidhura me statusin e dosjeve. Këto përmirësime do të rrisin përgjegjshmërinë, efikasitetin dhe efektivitetin e proceseve, do të zvogëlojnë koston, dhe do të sigurojnë gjurmë të qarta të auditimit.

2.1.2. Të përmirësohet ndjeshëm sistemi i menaxhimit të regjistrit nëpërmjet vendosjes së një arkivimi adekuat. Për këtë qëllim, të shqyrtohet zbatimin i aktiviteteve si në vijim: ndarjen e hapësirave të përshtatshme, ndërtimin e një objekti të ri sipas mundësisë, kontraktimin e këtij funksioni me punësimin e një profesionisti special të ngarkuar me këtë punë, duke siguruar trajnime adekuate profesionale për punë. Të përmirësohet baza e të dhënave dhe sipas mundësisë, të futet skanimi profesional duke përdorur teknologjitë e TI-së për të përmirësuar mbajtjen e shënimeve.

Planifikimi i buxhetit. Buxheti dhe sistemi i menaxhimit financiar. Asetet.

Arsyetimi: Planifikimi i buxhetit dhe menaxhimi i buxhetit, si dhe menaxhimi financiar dhe i aseteve duken të jenë kritike për mbrojtjen e integritetit. Çdo keq-menaxhim në këtë drejtim, do të çojë në humbje jo vetëm materiale, por

edhe në dëmtim të reputacionit dhe besimit, të cilat vështirë kompensohen në afat të shkurtër dhe të mesëm. Vlerësimi i rrezikut të integritetit i realizuar në komunën e Mamushës tregon se stafi është në dijeni për kompleksitetin në planifikimin aktual buxhetor dhe proceset e menaxhimit si dhe profilin e tyre të rrezikut. Fusha me rrezik të lartë janë parë në cënueshmëritë dhe rreziqet e mundshme vijuese: mungesa e regjistrimit të aseteve që mund të rezultojë me keqpërdorim të tyre; procesimi i pagesave ndaj kreditorëve në këmbim të favoreve; keqpërdorimi i automjeteve komunale për përfitime personale; procesimi i pagesave për furnizuesit. Në mënyrë që të minimizohen nivelet e ndërlidhura me rrezikun, kontrollet operative të integritetit që janë dëshmuar të jenë efektive në vende të tjera, dhe mund të shqyrtohen për aplikim në Komunën e Mamushës, përveç rregulloreve ligjore të zbatueshme, ndër të tjera përfshin: ndarjen e vazhdueshme të detyrave në fusha të caktuara me rrezik të lartë; nivelin e duhur të shkallëzimit të autoritetit për aprovimin e pagesës; duke siguruar se caktimi i të paguarit dhe puna ose shërbimet e kryera janë aprovuar duke përdorur mekanizmat specifikë të aprovimit; duke kërkuar të paktën dy nënshkrime për aprovimet e pagesës; duke kërkuar dokumentacionin përkatës mbështetës që t'i shtohet aprovimit të pagesave; duke kufizuar përdorimin e parave të gatshme; duke siguruar që kategorizimet e pagesës dhe përshkrimet në llogari janë të sakta dhe të qarta; duke aplikuar rishikime periodik të menaxhmentit për transaksione të rëndësishme financiare; duke zbatuar auditime periodike financiare.

2.2.1. *Të promovohet në mënyrë aktive pjesëmarrja e palëve të interesuara: e Qytetarëve/Bizneseve/OJQ-ve në planifikimin e buxhetit duke organizuar fushata përkatëse të ndërgjegjësimit dhe informimit, duke ofruar informacionin në kohë, duke siguruar se projekt buxheti është publikuar dhe është në dispozicion për komente, monitorimi i rregullave dhe procedurave ekzistuese të kuvendit komunal mbi pjesëmarrjen e publikut në planifikimin e buxhetit dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese të nevojshme, sipas nevojës.*

2.2.2. *Të përmirësohen në mënyrë të ndjeshme proceset e koordinimit dhe komunikimit të lidhura me planifikimin e buxhetit. Të monitorohet rreptësisht zbatimi i afateve të parashikuara dhe të merren në konsideratë masat e duhura korrigjuese për të garantuar zbatimin e efektshëm dhe në kohë.*

2.2.3. *Të promovohet pjesëmarrja e qytetarëve/bizneseve/ OJQ-ve në monitorimin e realizimit të buxhetit duke: organizuar debate publike/ forume për të informuar qytetarët në lidhje me realizimin e buxhetit, duke botuar raporte periodike mbi realizimin e buxhetit në kohën e duhur, në mënyrë që palët e interesuara mund të gjurmojnë shpenzimet buxhetore dhe të mbajnë komunën të përgjegjshme.*

- 2.2.4. *Të përmirësohen procedurat ekzistuese mbi menaxhimin e buxhetit* që sigurojnë se komuna është e pajisur mire me procedura gjithëpërfshirëse të brendshme të cilat përshkruajnë në mënyrë të qartë proceset/aktivitetet themelore, linjat e raportimit dhe llogaridhënies. Ato duhet të jenë në përputhje me Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe klasifikimin e vendeve të punës, dhe sistematizimin e tyre.
- 2.2.5. *Të plotësohen funksionet e menaxhimit të buxhetit dhe menaxhimit financiar* me burime adekuate njerëzore sipas nevojës, dhe të aftë që të punojnë sipas standardeve profesionale. Të sigurohet *se stafi është i aftësuar mirë* duke shfrytëzuar çdo mundësi që mund të lind, duke përfshirë trajnimet e organizuara nga organet qendrore, IKAP, donatorët, etj. Të caktohet një pikë kontakti në nivel lokal për trajnime të tilla e që është i ngarkuar për të parë mundësitë e tilla në mënyrë periodike.
- 2.2.6. *Të shqyrtohet futja e një sistemi të besueshëm/mekanizëm adekuat për gjurmimin e shpenzimeve buxhetore* në intervale të planifikuara (p.sh në baza mujore) në mënyrë që të mundësohet kontabilitet më i mirë i dinamikës së realizimit të buxhetit. Të monitorohen dhe shlyhen të gjitha pagesat në baza mujore. Të sigurohen analiza të tendencave dhe të vlerësohen në përputhje me rrethanat.
- 2.2.7. *Të zhvillohet/mirëmbahet një regjistër i aseteve.* Organizon përditësimin e saj të rregullt dhe të monitorojë atë në baza mujore.
- 2.2.8. *Të shqyrtohet futja dhe zbatimi i masave efektive për parandalimin e përdorimit të automjeteve komunale për nevoja personale*, p.sh. regjistri i automjeteve, shfrytëzimi i kartelave të karburantit e që janë me PIN, monitorimin përmes GPS të automjeteve me vlerë të lartë. Të kryhen auditime ad hoc për të fuqizuar respektimin e rregullave të përcaktuara dhe parandalimin e keqpërdorimit.

Prokurimi publik

Arsyetimi: Gjatë vlerësimit të rrezikut të realizuar në komunën e Mamushës, praktikën e prokurimit dhe të kontraktimit janë parë si fushë e rrezikut të mundshëm të korrupsionit. Edhe pse të dhënat e tanishme komunale tregojnë një nivel të kënaqshëm të performancës sa i përket prokurimit publik, kontrollin operative mund të fuqizohen edhe më tej në fushat si në vijim (të vlerësuara në përputhje me nivelet e rrezikut): vlerësimin e ofertave; formulimin e kriterëve të përzgjedhjes; kontrollin e realizimit të kontratave; monitorimin financiar

të realizimit të kontratës; planifikimin e prokurimit të nevojave; fazën e para-tenderit: përgatitjen dhe publikimin e planeve/ofertave të prokurimit; kontrollin e cilësisë së realizimit; ndryshimet në kontrata; vendimi i dhënies së kontratës dhe arsyetimi; afatet dhe kushtet e kontratave.

2.3.1. Të përmirësohet *struktura qeverisëse* në Njësinë e Prokurimit. Të përmirësohen *praktikat e koordinimit dhe komunikimit* ndërmjet njësive të prokurimit publik dhe drejtorive tjera komunale.

2.3.2. Të përmirësohen *kapacitetet e stafit* të përfshirë në gjitha fazat e prokurimit publik. Të sigurohet të kuptuarit adekuat ndaj kërkesave teknike të ligjit të Prokurimit Publik, natyrën dhe përdorimin e kriterëve të vlerësimit të tenderit, konceptin e vlerës më të mirë për paratë dhe se si të kontrollohet cilësia e mallrave/shërbimeve/punëve të marra përmes praktikave dhe procedurave të tenderit; mbrojtja e të drejtave të ofertuesve dhe zbatimi i drejtë i procedurës në nivel komunal.

2.3.3. Të përmirësohet *procesi i planifikimit të nevojave*, me afate të harmonizuara dhe procedura të përmirësuara në lidhje me termat e referencës të njësishë kërkuese.

2.3.4. Të shqyrtohet *përshtatja e procesit të përgatitjes së ofertave* për kompensimin e mangësive të stafit dhe burimeve. Për këtë qëllim, të shqyrtohet standardizimi i përgjithshëm dhe përdorimi i dokumentacionit model të tenderimit. Të zhvillohet dhe mirëmbahet një bazë e të dhënave elektronike e specifikimeve për lehtësimin e përgatitjes së ofertave të ardhshme. Të shqyrtohet përfshirja, në kushtet e kontratës model, e dispozitave të veçanta, duke përfshirë anulimin e kontratës, dhe dispozitave që trajton çështjet e korrupsionit dhe çështjeve të ndërlidhura.

2.3.5. Të shqyrtohen *procedurat/praktikat e brendshme të prokurimit publik* për identifikimin e mundësive për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit. Në mënyrë që të zvogëlohen mundësitë e sjelljeve abuzive, sipas mundësisë, të sigurohet *ndarja e duhur e detyrave*, si dhe detyrimet për raportim të brendshëm. Sipas nevojës, të sigurohet se funksionet e mëposhtme trajtohen nga punonjës të ndryshëm: rekomandimi për dhënien e kontratës, lëshimi i urdhër blerjes, vërtetimi mbi pranimin e mallrave dhe shërbimeve, si dhe verifikimi i pagesës.

2.3.6. Të rritet *transparenca e procedurave/praktikave të prokurimit publik*. Për këtë qëllim, të shqyrtohet zhvillimi i një standardi i pragut minimal të transparencës për të gjitha llojet e prokurimit publik, në përputhje me rregullat kombëtare dhe praktikat më të mira.

- 2.3.7. *Të promovohen në mënyrë efektive zotimet e integritetit në zinxhirin e vlerave.* Për këtë qëllim, të shqyrtohet futja e praktikës që t'i kërkohej kompanive të cilat bëjnë biznes me Komunë të vërtetojnë se ato janë në përputhje me zotimet e integritetit të Komunës së Mamushës dhe në përputhje me rrethanat, duke nënshkruar deklaratën e tillë të zotimeve.
- 2.3.8. *Të rritet mbikëqyrja e qytetarëve mbi prokurimin publik komunal, d.m.th përmes shfaqjes së informacionit publik në titujt e kontratave me vlera të larta, duke përfshirë përfaqësuesit nga OJQ-të dhe publiku i gjerë në monitorimin e prokurimit me vlerë të lartë apo komplekse i cili sjell rreziqe kritike të keq-menaxhimit dhe korrupsionit.*
- 2.3.9. *Të përmirësohet në mënyrë të ndjeshme kontrolli i integritetit në fazën pas-dhënies së kontratës nga prokurimi publik.* Për këtë qëllim, të shqyrtohet përmirësimi i cilësisë së kontrolleve mbi zbatimin e kontratave duke përdorur: komisionet për pranimin e rezultateve dhe aprovimin e produkteve të projektit, kërkesa më të rrepta për dokumentimin e kontrollit të cilësisë dhe pranimin e rezultateve/ produkteve.

Shërbimet publike

- 2.4.1. *Të optimizohet procesi i planifikimit të shërbimeve, lidhur me prioritetet afatmesme dhe afatgjata për ngritjen e cilësisë dhe gamën e shërbimeve të ofruara, si dhe kënaqshmërinë e klientëve.*
- 2.4.2. *Në mënyrë që të rritet cilësia, efikasiteti dhe transparencja e shërbimeve duhet të listohen të gjitha shërbimet e ofruara në Regjistrin e shërbimeve të Komunës së Mamushës. Të shikohet se a janë të mbuluara në mënyrë adekuate me procedurat operative përkatëse si dhe të shqyrtohet plotësimi i zbrazëtirave, nëse dhe ku është e nevojshme. Të përmirësohet konsiderueshëm ofrimi i informatave për qytetarët dhe bizneset si dhe qasja e tyre në shërbimet e ofruara nga komuna e Mamushës. Për këtë qëllim, të shqyrtohen mundësitë e publikimit të një liste të shërbimeve administrative si dhe informacioneve të detajuara si: adresën ku do të realizohet shërbimi, zyrtari përgjegjës, procedurat dhe kushtet, kosto dhe kohëzgjatja e ofrimit të shërbimeve, e drejta e ankimit në rast se pranuesi i shërbimit nuk është i kënaqur me cilësinë e shërbimit të ofruar. Për t'u siguruar që informacioni i mësipërm është plotësisht i disponueshëm përdorni faqen e internetit, në një format që mund të përdoret me lehtësi, dhe me të gjitha shabllonet/dokumentet e kërkuara. Ndani një hapësirë të veçantë në komunë për të postuar një informacionin të tillë. Të shqyrtohet publikimi i broshurave/shablloneve, në mënyrë që të bëhet më e lehtë për qytetarët dhe bizneset të njihen me të drejtat dhe detyrimet e tyre përkatëse.*

2.4.3. *Të trajnohet stafi në mënyrë periodike për ofrimin e shërbimeve me klientin në qendër. Të vetëdijesohet i gjithë stafi në lidhje me nevojën dhe vlerën e shtuar të ofrimit të shërbimit me klientin në qendër.*

2.4.4. Të rritet efikasiteti i shërbimeve, të sigurohet njohja e duhur e stafit me konceptet e *organizimit së shërbimeve* në “*One Stop Shop*”, si dhe *ofrimin e shërbimeve elektronike* dhe zhvillimet e fundit në Kosovë. Për këtë qëllim, caktoni një pikë kontaktuese për e-qeverisjen në mënyrë që të krijohet bashkëpunim me këta aktorë kosovarë përgjegjës dhe të përfshirë në e-qeverisje. Në kuadër të infrastrukturës teknike për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit, MAP, përkatësisht Agjencia për Shoqërinë e Informacionit tashmë ka ndërtuar një infrastrukturë të avancuar për ofrimin e shërbimeve elektronike nëpërmjet rrjetit shtetëror i cili mbulon të gjitha zyrat e administratës shtetërore (qendrore dhe lokale) dhe Qendra Shtetërore e të Dhënave, e cila ul koston për sigurimin e burimeve harduerike të IT. Kjo infrastrukturë shërben për të gjitha institucionet e nivelit qendror dhe lokal. Komuna e Mamushës, duke pasur parasysh burimet e saj të kufizuara, do të ndajë në faza planin e veprimit në mënyrë që të bëjë përdorimin më të mirë të mundshëm të kësaj infrastrukture dhe modernizimin e shërbimeve të saj.

2.4.5. Të shqyrtohet futja e instrumenteve për *matjen periodike të opinionit publik mbi cilësinë dhe qasshmërinë e shërbimeve të ofruara publike.*

Kujdesi shëndetësor

2.5.1. Të shqyrtohet rritja e duhur të numrit të stafit të përfshirë në ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve sociale, sipas nevojave të identifikuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të vlerësuar. Të fokusoheni në nevojën për të punësuar gjinekolog shtesë. *Në mënyrë progresive vazhdoni riorganizimin e ofrimit të proceseve të kujdesit shëndetësor* duke futur ndërrimin e 3-të.

2.5.2. Të përmirësohet koordinimin me aktorët përkatës për të rritur performancën e stafit mjekësor. Të përkrahen trajnim të rregullt rifreskuese profesional për stafin. Të rritet motivimi i stafit. Të rritet ndërgjegjësimi në lidhje me mbrojtjen e integritetit.

2.5.3. Të ofrohet një *inventar i detajuar* i pajisjeve ekzistuese në njësitë e kujdesit shëndetësor në Mamushë; vlerësimi dhe planifikimi për përmirësime të mëtejshme. Paraprakisht siguroni *vlerësimin adekuat të nevojave* për përmirësimin e koordinimit me udhëheqësin e

njesisë buxhetore në planifikimin e buxhetit në mënyrë që nevojat të llogariten në mënyrë efektive. Të rriten fondet për shëndetësi dhe të përkrahet procesi i vendimmarrjes të bazuar në prova.

- 2.5.4. Të përmirësohet në vazhdimësi infrastruktura fizike dhe teknike dhe pajisjet për të arritur standardet moderne. Të ndërtohet një ndërtesë të re- kati i dytë e qendrës së kujdesit shëndetësor. Të shqyrtohet investimi në përmirësimin e efijencës së energjisë dhe furnizimit me ujë të nxehtë përmes përdorimit të energjisë diellore për ngrohje të ujit.
- 2.5.5. Të përkrahet *digjitalizimi i Sistemit të Informimit Shëndetësor* në nivel lokal për të zvogëluar mundësitë e sjelljeve abuzive dhe të përmirësohet llogaridhënia.

Arsimi, kultura dhe sporti

- 2.6.1. Të përmirësohet *procesi i planifikimit*. Sigurimi i mbështetjes për ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm me harmonizim më të mirë të rritjes së numrit të nxënësve me kapacitetet aktuale. Të përmirësohet *parashikimi dhe procesi i vlerësimit*, të integrohen rezultatet e tyre në procesin e planifikimit dhe buxhetit komunal. Të përmirësohet *koordinimi dhe komunikimi* me akterët në nivel qendror për të siguruar që nevojat janë prezantuar dhe komunikuar siç duhet.
- 2.6.2. Të përmirësohet infrastruktura shkollore dhe kushtet e mëtejshme (ndërtesa, fusha sportive, IT, materiale mësimore, etj). Të mbështetet prezantimi i programeve të higjienës në formate të përshtatshme.
- 2.6.3. Të bëhet zhvillimi dhe zbatimi konsekuent i *procedurave/standardeve të qarta dhe transparente për rekrutimin e mësimdhënësve*. Të shqyrtohet hapja e procesit, duke nxitur mundësinë për të përfshirë OJQ-të, akterët e tjerë të jashtëm në panelet intervistuese, rritjen e transparencës së procesit të intervistimit dhe rritjen e publicitetit të rezultateve.
- 2.6.4. Të mbështeten *trajnimet periodike të instruktorëve dhe administratorëve të arsimit*. Të angazhohen mësimdhënësit në trajnime të rregullta freskuese profesionale. Të përfshihet mbrojtja e integritetit në kurrikulat e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Në mënyrë aktive të promovohet shkëmbimi i përvojave dhe njohurive me shkollat e tjera në Kosovë.

- 2.6.5. Të rritet transparenca dhe promovimi i angazhimit të qytetarëve, të mbështetet krijimi i *forumeve prindër-mësimdhënës*; të mundësohet angazhimi aktiv i prindërve në sigurimin e cilësisë dhe integritetin e procesit të arsimit (ditët e dyerve të hapura, etj)
- 2.6.6. Të inkurajohet përfshirja e çështjeve të integritetit në kurrikulën e bazuar në shkollë.

Zhvillimi ekonomik

- 2.7.1. Të përmirësohet *struktura qeverisëse në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik*.
- 2.7.2. Të përmirësohen kapacitetet e stafit të përfshirë në planifikimin e zhvillimit ekonomik. Të konsiderohet ngritja/fuqizimi i kapaciteteve në fushat e mëposhtme kryesore: zhvillimi territorial ekonomik, strategjitë e zhvillimit territorial: mjetet për analiza, identifikim, dhe kornizë strategjike, qeverisja për zhvillim ekonomik territorial, planifikimi zhvillimit ekonomik lokal, shërbimet për zhvillim ekonomik, marketing territorial.
- 2.7.3. Sipas nevojës, shqyrtoni mundësitë për të fuqizuar qasjen më pjesëmarrje, nëpërmjet përfshirjes transparente të akterëve publik dhe social në procesin e vendimmarrjes. Të forcohen lidhjet ndërmjet prodhuesve dhe komunës, ndërmjet drejtorive komunale (ekonomi, bujqësi, arsim etj), ndërmjet Mamushës dhe komunave fqinje. Të shqyrtohet krijimi i një forumi të përbashkët komunal për zhvillim dhe planifikim ekonomik, duke përfshirë edhe komunat, përfaqësuesit e komuniteteve të biznesit, OJQ-të, ekspertë, me detyrën e ndarjes së prioritetëve për strategjitë vjetore dhe shumëvjeçare dhe planet në lidhje me zhvillimin ekonomik dhe monitorimin e zbatimit. Ky forum do të ngarkohet me identifikimin e objektivave dhe prioritetëve për zhvillim, si dhe për monitorimin e tyre.

Gjeodezi dhe Kadastër

- 2.7.4. Në mënyrë të konsiderueshme të përmirësohen praktikat e menaxhimit të të dhënave në kadastër. Për këtë qëllim, të shqyrtohet futja e një sistemi të realizueshëm të skanimit profesional dhe arkivimit, duke përdorur mjete të IT-së sa më shumë që është e mundur.

- 2.7.5. *Të trajnohet stafi sipas nevojës, ofroni trajnime rifreskuese në udhëzimet e reja apo kornizat për matjet kadastrale. Të inkurajohet pjesëmarrja e stafit në rrjetet përkatëse të ekspertëve, konferenca, me qëllim inkurajimin e praktikave të mira dhe të mësuarit.*
- 2.7.6. *Të fuqizohen/diversifikohen mekanizmat e kontrollit, duke përfshirë kontrollet ad hoc, linjat direkte të sugjerimit për shqetësimet në lidhje me kadastrin. Kushtoni vëmendje të veçantë zonave me rrezik të lartë: zyrave pritëse, regjistrimit dhe çregjistrimit të hipotekave, etj.*

Urbanizmi

- 2.8.1. *Të fuqizohen kornizat institucionale dhe operative për funksionim. Të shqyrtohen procedurat ekzistuese për të marrë parasysh nevojën për udhëzime shtesë, si dhe kriteret e qarta operative dhe vendimtare për të zbutur rreziqet e lidhura me integritetin dhe parandalimin e vendimeve subjektive.*
- 2.8.2. *Të fuqizohet qasja strategjike në sistemin e planifikimit, fillimi i planifikimit afatmesëm të lidhur me prioritetet dhe për të parandaluar vendimet ad hoc. Ngritja/fuqizimi i kapaciteteve përkatëse të stafit në bazë të vlerësimit të nevojave për trajnime të synuara.*
- 2.8.3. *Në mënyrë të konsiderueshme të rritet transparenca dhe qasja me pjesëmarrje. Të parashikohet rritja e transparencës së planifikimit urban dhe rural duke marrë parasysh pragun e transparencës: informacionin minimal që duhet të publikohet, afatet e ndërlidhura, formatet etj. Kur është e mundur, shqyrtoni/prezantoni mundësitë për përfshirje më aktive të qytetarëve, bizneseve, OJQ-ve dhe akterëve të tjerë në procesin e planifikimit.*

Inspektimet

- 2.9.1. *Të përmirësohet struktura e qeverisjes në Njësinë e Inspektimit. Të bëhet harmonizimi i më tejshëm i strukturës organizative me organizimin e brendshëm dhe kuadrin rregullator, të bëhet ofrimi i linjave të qarta të llogaridhënies dhe detyrimet përkatëse të raportimit.*

2.9.2. *Të përmirësohen burimet e funksionit të inspektimit.* Të bëhet ngritja e profesionalizmit të stafit në teknikat e veçanta hetimore, bazuar në vlerësimin e nevojave të synuara. Kur është e mundur, mbani parimin e “rotacionit” dhe atë “në katër sy” për të shmangur daljen dhe fuqizimin e marrëdhënieve korruptuese; Të shqyrtohen mundësitë për të rritur stimujt e punës në sistemin e tanishëm të shpërblimit, d.m.th puna në koeficientin e rrezikut.

2.9.3. Të rritet në mënyrë të konsiderueshme përdorimi ad hoc/inspektimeve të paplanifikuara.

2.9.4. Të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme *monitorimi i aktiviteteve të njësisë së inspektimit*, duke përfshirë zbatimin e planeve për inspektime, llojet e inspektimeve, çështjet e hasura, tendencat etj.

Bujqësia dhe zhvillimi Rural

2.10.1. Të përmirësohet *struktura e qeverisjes në njësinë e bujqësisë* për të analizuar se ku janë të mbingarkuara proceset dhe si mund të thjeshtohen; Të zhvillohet një procedure e brendshme adekuate/kritere të qarta që adresojnë rreziqet kryesore të integritetit në sektorin e bujqësisë dhe parandalimin e vendimeve subjektive; Të shqyrtohet struktura organizative.

2.10.2. *Të fuqizohet sistemi i planifikimit*, të filloj planifikimi afatmesëm për tu lidhur me prioritetet dhe për të parandaluar vendimet ad hoc. Për të shmangur subjektivizmin dhe mundësitë për abuzim, merrini parasysh *kritere të qarta për të përcaktuar se cilëve sektorë duhet t'i jepen subvencione*. Siguroni plane afatmesme kohore se si të ndahen mjetet në sektorin e bujqësisë.

2.10.3. Të sigurohet se *stafi është trajnuar në mënyrë adekuate*.

2.10.4. Të përmirësohet *sistemi i koordinimit dhe komunikimit* ndërmjet njësive.

Banimi publik

2.11.1. Të fuqizohet *transparenca dhe kërkesat për dokumentacione*, si dhe kontrollet operative në menaxhimin e proceseve të banimit publik.

2.11.2. Të fuqizohen kontrollet mbi ndërtuesit e përfshirë në rindërtimin e banimeve komunale: dmth sigurimin e cilësisë dhe kontrollet, pagesat e kontraktuesve të ndërtimit.

2.11.3. Të shqyrtohet institucionalizimi i një *mekanizmi të komenteve kthyesë* për të ndjekur kënaqshmërinë me punën e kontraktuesve.

Arranzhimi i qasjes dhe sigurisë

2.12.1. Të shqyrtohet fuqizimi i kontrolleve të sigurisë fizike, duke u bazuar në një shqyrtim të hollësishëm të masave të sigurisë fizike; p.sh fokusi specifik të jetë në sigurinë fizike mbi infrastrukturën, asetet dhe stafin.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3:

Promovimi i çiltërsisë dhe transparencës dhe mobilizimit të kapaciteteve të grupeve kryesore të akterëve të jashtëm për të vepruar si bashkëpronarë në reformat e integritetit për të mirën e të gjithë komunitetit lokal.

Linjat e aktivitetit dhe masat përkatëse

3.1. Të fuqizohet pjesëmarrja e akterëve kyç në proceset kritike për të nxitur angazhimin kolektiv dhe për të fituar bashkëpronësinë në reformat e integritetit

Arsyetimi: Përfshirja në kohë dhe kuptimplotë e qytetarëve, bizneseve dhe OJQ-vë në jetën e komunës krijon angazhim aktiv dhe rrit gatishmërinë për të zbatuar rregullat e futura dhe masat e planifikuara. Në komunën e Mamushës, njohja e këtij potenciali ekziston, edhe pse mjetet për shfrytëzimin efektiv për të mirën e komunitetit lokal janë ende në fazë të hershme. Kjo kërkon formimin dhe zbatimin e politikave të konsultimit dhe komunikimit që efektivisht i bashkon akterët drejt arritjes së vendimeve/zgjidhjeve në kohë në interes të komunitetit lokal.

3.1.1. Të familjarizohen këshilltarët Komunal me këtë Plan të Integritetit. Të krijohen kushte dhe të nxitet pjesëmarrja e këshilltarëve komunal në ngjarjet e ndërlidhura të vetëdijesimit/PR, për të treguar mbështetjen e lidhshme në reformën e administratës dhe agjendën e modernizimit.

3.1.2. Të konsiderohet miratimi i një *politike proaktive për pjesëmarrjen e publikut* dhe një plan mbështetës të veprimit për periudha të planifikuara që përfshin ngjarjet kryesore ku nevojitet konsultimi publik, p.sh para se buxheti i ri, rregulloret dhe/ose projektet e

zhvillimit ekonomik të fillojnë dhe/ose planet të finalizohen. Të konsiderohet ngritja e *komiteteve teknike me palë të interesuara mbi tema specifike* (arsim, shëndetësi, infrastrukturë, etj) me role të përziera mes mbikëqyrjes/konsultimit. Të përfshihen shoqëria civile/biznesi me përfaqësuesit e drejtorive përkatëse komunale dhe ofruesit e shërbimeve. Këto komitete mund të ndërlidhen me komunën në bazë të nevojës për të ndërtuar mbi përvojën e saj në shfrytëzimin e shoqërisë civile për të lehtësuar mbikëqyrjen publike.

3.1.3. Të përdoren në mënyrë efektive *mundësitë ekzistuese për t'u bërë partner* me Asociacionin e Komunave të Kosovës, Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe komuna të tjera të Kosovës në fushën e integritetit dhe kundër-korrupsionit, si dhe mundësitë për të marrë ndihmë përkatëse teknike nga donatorët për të nxitur ngritjen e kapaciteteve dhe aktiviteteve të mëtejshme të integritetit. Për këtë qëllim, duhet të krijohet një strukturë e bashkëpunimit dhe komunikimit: pika kontakti, TeR, mekanizmat e raportimit dhe monitorimit.

3.1.4. Të konsiderohet mbajtja e një *linjë telefonike të sigurt kundër-korrupsion për qytetarët dhe bizneset* me qëllim që Komuna të ketë një kanal të besuar për raportimin e shkeljeve të integritetit. Të parashihet siguria e përdoruesve, ofrimi me kohë i komenteve kthyesë adekuate tek ankuesit. Përpikuni të integroni gjetjet/rezultatet në sistemin e menaxhimit në bazë të analizave të trendëve dhe masave.

3.2. Të rritet në maksimum shtrirja e transparencë

Arsyetimi: Potenciali i transparencës si nxitës kyç për të ndikuar pozitivisht në cilësinë, intensitetin dhe dinamikën e marrëdhënieve ndërmjet komunës dhe akterëve të saj të ndryshëm janë dëshmuar të jenë të mëdha. Edhe pse kjo është e njohur edhe në Komunën e Mamushës, është akoma një fushë e cila ka nevojë për zhvillim të mëtejshëm. Përmirësime të konsiderueshme mund të arrihen përmes sigurimit se përpjekjet, burimet, politikat dhe klima e nevojshme operative janë vendosur.

3.2.1. Të plotësohen me staf adekuat funksionet e PR dhe TI, për t'i mundësuar komunës të ndjek në mënyrë efektive politikat e jashtme të komunikimit të bazuara në nevoja dhe të fokusuara në klient. Të aftësohet stafi për shkathtësitë e TI-së e nevojshme për të zhvilluar/mbështetur ueb-faqet dhe për të ruajtur transparencën miqësore ndaj përdoruesit.

- 3.2.2. Të shqyrtohet politika aktuale e komunikimit/praktikat e PR dhe të shqyrtohet mundësia e përmirësimit duke shtuar fokusin e integritetit. Të publikohet përkushtimi për integritet i Komunës, gjithashtu edhe zbatimi i masave të integritetit, në intervale të rregullta, e kjo do të përmirësojë pozitivisht dhe dukshëm imazhin e Komunës së Mamushës në fushën e mbrojtjes së integritetit. Të harmonizohet kjo politikë me *udhëzimin e ri administrativ për transparencën në komuna*. Të sigurohet zbatimi i tij duke krijuar kornizën e nevojshme të brendshme dhe procedurale: rregullat, përgjegjësitë dhe monitorimin e zbatimit.
- 3.2.3. Të ofrohet kujdesi i duhur për *ueb-faqen* institucionale, duke siguruar zbatimin e udhëzimit në uebfaqet e institucioneve dhe krijimin e një sistemi për të monitoruar zbatimin dhe përditësimin e saj të rregullt. Sipas nevojës dhe arsyes, të publikohen informata në lidhje me fushat kryesore të funksionimit të Komunës: ligjet/rregulloret përkatëse; Kodin e Sjelljes; raportet vjetore të menaxhimit; “raportet buxhetore lehtësisht të kuptueshme” të cilat ofrojnë një pasqyrë të thjeshtë të veprimeve financiare; prokurimit; rekrutimit dhe vendeve të lira; aktivitetet dhe vendimet e marra nga kuvendi komunal. Të punohet me drejtoritë komunale, OJQ-të dhe ekspertët e komunikimit dhe medias për të identifikuar të dhënat e mbajtura nga komuna të cilat mund të botohen për të përmirësuar transparencën dhe për të zvogëluar marginën e shkeljeve të integritetit.
- 3.2.4. Të konsiderohet ngritja e zyre/stende për *transparencë* për publikun në një vend të hapur për vizitorët, ku broshurat, rregulloret, urdhëresat, njoftimet, standardet e shërbimit, doracakët/shabllone të referencës/ndihmës, etj, mund të prezantohen në një format lehtësisht të përdorshëm.
- 3.2.5. Të përdoren në mënyrë efikase mundësitë e organizimit të “*Ditët e dyerve të hapura*” në zyrat e zyrtarëve të lartë komunal, si dhe në mbledhjet e Këshillit Komunal për të përmirësuar të kuptuarit e publikut rreth funksioneve të punës, përgjegjësi të lidërshiptit dhe zgjerimin e dukshmërisë. Për këtë qëllim, bëni një listë të Ditëve të Hapura në një periudhë të planifikuar, ndani përgjegjësitë, publikojeni në përputhje me rrethanat, të bëhet organizimi dhe të sigurohet monitorimi i implementimit. Të shfrytëzohen këto ditë për të marrë komente kthyesë të strukturuar mbi aktivitetet e administratës, duke përfshirë cilësinë e shërbimeve dhe të performancës së integritetit.

3.3. Të fuqizohet qasja e informacioneve publike si instrument kyç në sigurimin e transparencës dhe rritjen e llogaridhënies

Arsyetimi: Qasja e lirë dhe e lehtë për informimin e publikut është një gardian i rëndësishëm në sigurimin e integritetit dhe ofrimin e mbikëqyrjes së shëndoshë të qytetarëve rreth aktiviteteve të administratës. Disponueshmëria e ligjeve dhe rregulloreve përkatëse në nivel kombëtar, nuk do të mjaftojë për të garantuar mbrojtjen në nivel lokal në qoftë se nuk ka struktura të zbatimit ose janë të dobëta, dhe në qoftë se nuk mbështetet nga burimet, kompetencat, rregullat dhe mekanizmat e nevojshëm monitorues. Zbatimi efektiv kërkon njohuri dhe familjarizim të duhur si dhe qëndrime proaktive nga ana e klientëve të shërbimeve komunale. Rritja e ndërgjegjësimit është një ndër fushat që Komuna e Mamushës mund të konsideroj veprime të mëtejshme.

- 3.3.1. Të sigurohet se stafi është i *trajnuar mirë* në kornizën rregullative dhe procedurale përkatëse që rregullon qasjen në informatat publike me fokus në përgjegjësitë e administratës.
- 3.3.2. Kur është e mundur, të promovohet *ndërgjegjësimi i akterëve* mbi të drejtat e tyre sa i përket qasjes në informata.
- 3.3.3. Të shqyrtohet sistemi aktual i organizimit të *qasjes në informata publike*, bazuar në mjedisin rregullativ kombëtar. Të shqyrtohet mundësia e përditësimit të këtij sistemi për të mundësuar qasje të lirë dhe të lehtë për të gjithë palët e interesuara. Kjo mund të përfshijë, por nuk kufizohet vetëm në miratimin e procedurave/rregullave të brendshme për përpunimin e kërkesave për qasje në informata publike; ofrimin e shabllonëve të nevojshëm, informacionin në terren për dorëzimin e informatave publike dhe shpenzimeve të ndërlidhura.
- 3.3.4. Të shqyrtohet krijimi i *një baze të të dhënave të kërkesave për qasje* në dokumente publike dhe informacione për të mundësuar gjurmët efektive të auditimit. Të parashikohet organizimi i monitorimit të zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike nga Komuna dhe të ndahen përgjegjësitë përkatëse. Të ndërmerren veprimet e menjëhershme korrigjuese në rastin e raportimit/identifikimit të mangësive. Raportoni në rast të mospërputhjeve, trendeve, etj.

PLANI I VEPRIMIT						
Objektivat Strategjike						
Veprimi/Masa	Njësia përgjegjëse	Njësia koordinuese e partneritetit me aketër	Afati për zbatim	Indikatorët e suksesit	Kostoja financiare dhe burimi i financimit	
Veprimet/masat për të mbështetur zbatimin e objektivave	Komuna e Mamushës-përgjegjëse për zbatimin e masave të veçanta	Njësiti e bashkërendimit të zbatimit dhe institucionet/organizatat partnere	Koha e parashikuar për të përfunduar zbatimin e veprimeve specifike	Indikatorët që shërbejnë për të verifikuar zbatimin e veprimit.	Paraqet buxhetin e nevojshëm për zbatimin e veprimit përkatës nga buxheti i Republikës së Kosovës ose donatorë të ndryshëm.	

Promovimi i çiltërsisë dhe transparencës dhe mobilizimit të kapaciteteve të grupeve kryesore të akterëve të jashtëm për të vepruar si bashkëpronarë në reformat e integritetit për të mirën e të gjithë komunitetit lokal

[illegible]

